



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 154, datë 29.03.2023

PËR

MOSFILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN), PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-2016, PËR GJYQTAREN {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.03.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Irena Plaku, si dhe, pasi shqyrtoi propozimin mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...},

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), nenit 25 të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka si detyrë të fillojë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit është edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me shkresën me nr.702, datë 16.02.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, protokolluar me nr.1357 prot., datë 16.02.2023, është dërguar dosja e gjyqtarës {...}, së bashku me aktet e vlerësimit profesional si dhe vendimi nr.610, datë 27.12.2022 që ka vendosur konfirmimin e saj në detyrën e gjyqtarës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar e drejta e ankimit.

3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se Znj. {...} në periudhën tetor 2013- Korrik 2016 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga nëntori 2015 deri në muajin korrik 2016 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është dekretuar me dekretin e Presidentit të Republikës me nr.9326, datë 20.11.2015. Me vendimin nr.13, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Z. {...} është caktuar të ushtrojë funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, Znj. {...} ka ushtuar detyrën e gjyqtares vetëm në periudhën e kryerjes së praktikës profesionale në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, nga muaji nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016 (në fund të këtij muaji), për një kohëzgjatje prej 8 muajsh e 11 ditë. Ndërsa ajo është caktuar për të ushtuar funksionin e gjyqtares në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 10.02.2017 (jashtë periudhës së vlerësimit). Pra ajo është caktuar në detyrën e gjyqtares jashtë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të përcaktuar në nenin 171, pika 5 të Ligjit për Statusin.

5. Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 03.03.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores dhe ka vendosur të miratojë propozimin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (gradimit), për gjyqtaren {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

6. Në datë 23.03.2023, nëpërmjet postës elektronike, gjyqtares i është njoftuar relacioni mbi projektvendimin “*Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}*”, duke iu njoftuar njëkohësisht:(i) e drejta për të paraqitur kundërshtime/shpjegime me shkrim dhe (ii) e drejta për t’u dëgjuar në Mbledhjen Plenare të Këshillit, duke iu komunikuar data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes. Po në datë 23.03.2023 gjyqtarja ka konfirmuar marrjen dijani, si dhe ka deklaruar se kjo vendimarrje bie në kundërshtim me vendimarrjen e Këshillit, ku ajo është konsideruar subjekt i rivlerësimit, duke kryer vlerësim profesional për të, për organet e rivlerësimit (Komisionit të Pavarur të Kualifikimit), por se është dakord me këtë qëndrim të ri pasi ajo në atë periudhë ka gëzuar statusin e kandidates për gjyqtare, dhe se nuk ka kundërshtime lidhur me relacionin mbi projektvendimin, si dhe nuk do të ushtrojë ankim ndaj tij, duke mos kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

7. Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin i kohës nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 parashikonte se :

“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë tre vjeçare që përbëhet nga:

a) Një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Programi teorik sipas germës a) të nenit 14 është i përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa viti praktik dhe viti i stazhit profesional zhvillohen sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror..”.

8. Në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohet se :

“Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magjistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.”

9. Ndërsa në nenin 19/1 parashikohet se : “Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë:

a) shkëlqyeshëm; b) shumë mirë; c) mirë; ç) mjaftueshëm; d) pamjaftueshëm. Rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

10. Lidhur me vlerësimin e vitit të tretë, në nenin 20, paragrafi i parë i ligjit, parashikohet se :

“Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit.”

11. Po ashtu në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, në nenin 27 të saj, në fuqi në momentin kur gjyqtari ka përfunduar stazhin e tij profesional, parashikohet se :

“Pas përfundimit të stazhit paraprofesional, kandidatët i nënshtrohen stazhit profesional, i cili konsiston në pjesëmarrjen aktive në ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën udhëheqjen e një gjyqtari ose prokurori...”

Në fund të stazhit profesional bëhet vlerësimi i akteve dhe vendimeve të përpiluara nga kandidatët gjatë vitit. Secili prej tyre depoziton dosjen me materialet në sekretarinë shkencore në afatin e caktuar. Ndarja e dosjeve bëhet me short dhe vlerësimi bëhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi përfundimtar i vitit të tretë bëhet nga Këshilli Pedagogjik.”

12. Neni 97, pika 3 i Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikon se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”. Ndërkohë në nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik.....”.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

13. Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të kohës, referuar më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshtruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtarja {...} e ka pasur statusin e gjyqtarit edhe gjatë praktikës profesionale, që korespondon me vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës.

14. Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtën periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të 3/të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të 3/të sipas ligjit të kohës, ka pasur statusin e gjyqtarit, i vetmi organ që ka pasur kompetencën e vlerësimit etik dhe profesional të tij ka qenë Shkolla e Magjistraturës, vlerësim mbi të cilin është bërë edhe pikëzimi dhe renditja e saj me rastin e diplomimit nga kjo Shkollë.

15. Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën vlerësimit 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, **Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës**”. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë

analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet: “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo “mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerësimit lidhur më të.

16. Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit “Për Statusin”, vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur. Me termin “Ligj” do të kuptohet jo vetëm Ligji për Statusin, por edhe Ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence të organit, gradimin e gjyqtarëve, sikundër është Ligji nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcaktonte Shkollën e Magjistraturës si organ kompetent për të bërë vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve në vitin e tretë të programit të formimit fillestar. Në rastin konkret, duke qenë se për periudhën nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016, gjyqtarja {...} ka kryer stazhin profesional, që përkon me vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës ka bërë vlerësim etik dhe profesional të saj, mbi bazën e të cilës më pas është bërë rënditja dhe emërimi i saj nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

17. Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të Znj. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3/vjeçare të vlerësimit 2013-2016, rezulton se ajo nuk është caktuar dhe nuk ka ushtruar detyrën si gjyqtare gjatë periudhës së vlerësimi, pasi është caktuar si gjyqtare për të ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 10.02.2017, pra jashtë kësaj periudhe vlerësimi.

18. Në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, parashikohet se :

“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar.

2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat..””.

19. Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5, parashikohet se :

1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin...

3. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.”

20. Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për Znj. {...}, në kushtet kur rezultoi se ajo nuk ka ushtruar detyrën si gjyqtare, pas përfundimit të stazhin profesional, gjatë periudhës së

vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhe të plotë vlerësimi në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 3 dhe 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3/vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të fillojë.

21. Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative, në lidhje me nenin 171 pika 5 të Ligjit “Për Statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme :

- 1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit duke u konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
- 2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;
- 3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

22. Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr.86, datë 07.12.2022, vendim i cili ka rrëzuar padinë e gjyqtarit G.M, duke pranuar arsyetimin e Këshillit për pamundësinë në objekt e qëllim të procedurës së gradimit të filluar për këtë gjyqtar, ka arsyetuar se : “.....kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting nga gjyqtari G.M, përbënte rrethanë të pamjaftueshme për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional/vlerësimit periodik, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit/gradimin, përse kohë që nuk plotësohej edhe një tjetër kusht, ai i përvojës së punës/kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtar, jo më pak se një vit”. Gjykata e Apelit Administrativ konfirmon qëndrimin e Këshillit se kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting nga një gjyqtar, nuk e bën të pazbatueshme pengesën e parashikuar në nenin 5/4 të Vendimit nr. 263 dt. 21.11.2019 “ Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. KONKLUZIONI

23. Në përfundim, pasi analizoi faktet e çështjes, parashikimet e ligjit të zbatueshëm, Këshilli vlerëson se, për Znj. {...}, nuk duhet të fillojë procedura e vlerësimit etik dhe profesional sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, për shkak se mungojnë kushtet ligjore për fillimin e kësaj procedurë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 dhe 171 pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr.

115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtaren {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR
ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin Aurel Arapi.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari Aurel Arapi kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shyrtime gjyqësor dhe zgjedh legjislacionin e duhur për zgjidhjen e saj (shih dokumentin 1 dhe dosjen 5). Në çështjet me objekt zgjidhje martesë kur nga martesë ka fëmijë të mitur, zbaton procedurën e detyrueshme për marrjen e mendimit të psikologut lidhur me kujdestarinë e fëmijëve (shih dokumentin 2). Zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi (shih dokumentet 1, 2 dhe dosjet 3 e 5). Kualifikon drejt veprën penale atribuar të pandehurit dhe vendimet e dhëna ose nuk ankumohen ose kur ankumohen i lihen në fuqi (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1 e 4) në gjykimin e çështjeve penale njëh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim, veçanërisht pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim parashikuar nga neni 59 i K. Penal (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1 e 4). Në gjykimin e çështjeve penale njëh dhe zbaton gjykimin e posaçëm (gjykimin e shkurtuar) (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1 e 4). Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit të shpallur fajtor, njëh dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, “ndëshkimi penal në përpjestim me veprën e kryer”, “barazia para ligjit”, “Parimi i humanizmit” (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1 e 4). Në gjykimin penal për të pandehurit e mitur zbaton detyrimin ligjor për asistencën e tij nga psikologu, për asistencën e tij nga një avokat mbrojtës dhe zbatimin e nenit 51 të K. Penal për të mos dhënë më shumë se gjysmën e dënimit që parashikon dispozita penale. Në vendimet e tij sipas rastit referon tek Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, veçanërisht në zbatimin e vendimeve unifikuese (shih dokumentet 1,3 dhe dosjet 1, 2 e 4). Në vendimmarrjen e tij në një rast referon tek Jurisprudenca e GJEDJNJ-së (shih dosjen 2). Në një dosje penale ka referuar në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit (shih dosjen 4) etj....”*

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Gjyqtari në *vendimet penale*, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli ose kërkesë penale*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), i kushton rëndësi përcaktimit të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në një ose disa pjesë të arsytimit të vendimit, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo natyrës së gjykimit sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Në vendimet e themelit gjyqtari, nxjerr faktet e provuara nga tërësia e provave të administruara në gjykim duke përshkruan fillimisht kronologjinë e ngjarjes gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri/të pandehurit, duke i integruar në disa raste me provat mbi të cilat mbështeten faktet. Ndërsa në disa vendime konstatohet se gjyqtari nxjerr faktet e provuara nga tërësia e provave duke përshkruar edhe kronologjinë e ngjarjes, si dhe veprimet procedurale të kryera nga prokuroria, pa i gërshetuar gjithmonë me aktet provuese, të cilat në disa vendime vetëm listohen pas konkluzionit mbi faktin se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale për të cilën akuzohet¹. Elementë të faktit penal në disa vendime bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale, duke i kushtuar një rëndësi specifike paraqitjes dhe listimit të fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet analiza e provave dhe kualifikimi ligjor.

Në shtatë vendimet penale të analizuara (njëri vendim është kërkesë penale), nëpërmjet të cilave është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i të pandehurit, gjyqtari përgjithësisht evidenton dhe analizon faktet të cilat ndikojnë në individualizimin e dënimit.

Në kërkesën penale me objekt “*Vleftësim si i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit*”,² faktet e çështjes janë evidentuar në mënyrë përshkruese në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese, duke renditur në mënyrë kronologjike veprimet hetimore të kryera nga prokuroria në funksion të provueshmërisë së faktit penal të pretenduar, si dhe shkaqet objekt shqyrtimi, pa i gërshetuar me faktet me aktet provuese, por duke i listuar më pas aktet të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm në tërësinë e tyre.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes në *vendimet civile* të analizuara, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari përgjithësisht ka parashtruar në mënyrë të përmbledhura faktet e çështjes, në një pjesë të veçantë dhe të dallueshme të pjesës përshkruese arsyetuese, duke i gërshetuar në disa raste me aktet provuese që provojnë faktet konkrete. Ndërsa në një vendim konstatohet se nuk janë parashtruar aspak rrethanat e çështjet, si dhe provat e marra në shqyrtim, megjithëse ka një pjesë të titulluar – rrethanat e faktit. Konstatohet se as në pjesën arsyetuese-vlerësimit të gjykatës, gjyqtari nuk ka analizuar faktet e çështjes dhe aktet provuese në arritjen e konkluzionit përkatës për pranimin e padisë³.

¹ Vendimi nr.1038-181 datë 03.10.2016, Vendimi nr.668-115, datë 09.06.2016, vendimi nr.673-110-124, datë 10.06.2016, vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³ Vendimi nr.881-237, datë 28.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Paraqitja e fakteve të çështjes, duke iu referuar vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari apo të përzgjedhura me short, bëhet duke iu referuar përmbajtjes së kërkesë padisë, pretendimeve dhe shpjegimeve të palëve në gjykim dhe provave shkresore të administruara në seancë gjyqësore. Analiza e rrethanave të faktit jo gjithmonë bëhet në mënyrë të qartë dhe të plotë, megjithatë konstatohet se bëhet mbi bazën e një rendi kronologjik.

Provat e paraqitura nga palët jo gjithmone parashtrohen të ndara në raport me faktet të cilat ato provojnë, por një pjesë e tyre janë të integruara dhe të evidentueshme në mbështetje të rrethanave të faktit.

Sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përgjithësisht përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, por jo gjithmonë duke i gërshetuar këto fakte me provat përkatëse të marra në shqyrtim. Pra fakti juridik civil apo penal nuk vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, pasi në disa raste këto provua vetëm listohen në mënyrë të përmbledhur në një pjesë të veçantë tek çështjet penale, apo në disa raste citohet vetëm fakti se ato provohen nga fashikulli i hetimit të kthyer në fashikull gjykimi për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, pa cituar faktet apo rrethanat të cilat ato provojnë.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar, gjykim penal, apo kërkesë penale*) rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit. Evidentohet përgjithësisht në disa vendime analizë e detajuar e provave thelbësore të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ndërsa në disa vendime konstatohet se gjyqtari vetëm ka parashtruar rrethanat e faktet në pjesë e parë të vendimit, ndërsa tek analiza ligjore mjaftohet vetëm në arritjen e konkluzionit, pa i gërshetuar gjithmonë konkluzionin me provat konkrete të marra në analizë⁴.

Në të gjitha vendimet gjyqësore konstatohet se përgjithësisht gjyqtari tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, përveç se në vendimin nr.881-237, datë 28.07.2016 ku nuk del i qartë cilësimi i fakteve apo veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

⁴ Vendimi nr.881-237, datë 28.07.2016. vendimi nr.1038-181, datë 03.10.2016, vendimi nr.668-115, datë 09.06.2016, vendimi nr.673- 110-124, datë 10.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

-Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i faktit juridik, gjyqtari përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari përgjithësisht përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para detyrim pagim shume, marrëdhënie pune, pavërtetësi shënimesh etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale apo natyrën e kërkesës penale (*vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën; drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt; falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave; vrasjes me paramendim, korrupsionit pasiv*). Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese në disa vendime gjyqtari analizon juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes ndërsa në disa vendime mungon një analizë e tillë megjithëse për shkak të objektit të padisë, një analizë e tillë ka qenë e nevojshme në kushtet kur është kërkuar korigjimi i akteve të konsideruar me natyrë administrative nga gjyqtari⁵. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes nuk është identifikuar në mënyrë specifike, por del në shumicën e vendimeve del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në vendimet gjyqësor burim vlerësimi.

- Në drejtimit të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile/familjare dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

(*i*) Në vendimet civile (*dëshmërbllim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, zgjidhje martese, shpërbllim dëmi pasuror, pavërtetësi shënimesh etj*), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil,

⁵ Vendimi nr.121-33, datë 15.02.2016, vendimi nr.881-237, datë 28.07.2016, vendimi nr.702-179, datë 21.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

të Kodit të Punës, të Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse, nga ku evidentohet më konkretisht se:

- a) Në vendim gjyqësor me objekt “Dëmshtëpërblim nga marrëdhëniet e punës”⁶ gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 2 dhe 7/1 të K. Punës në lidhje me kompetencën tokësore, 12, 21, 141, 143, 144, 145, 146, 153, 154, 155 dhe 156 të K.Punës, në funksion të analizimit të fushës së zbatimit të këtij kodi, përkufizimit të marrëdhënies juridike të punës, llojin e kontratës, formën dhe përmbajtjen e saj, afatin dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, dëmshtëpërblimin për mosrespektim të afatit dhe procedurës si dhe pagimin e vjetërsisë në punë.
- b) Në vendimin gjyqësor me objekt “Detyrimin e të paditurve të paguajnë detyrimin e papaguar AMC sh.a.”⁷ gjyqtari identifikon dispozitat 419, 420, 422, 455, 476, 674, 690, 698 të K. Civil në lidhje me detyrimet që lindin nga kontrata, ekzekutimin e tyre, shpërblimin e dëmit. Në këtë vendim gjyqtari referon në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, të ndryshuar konkretisht në nenet 6, 8, 99, 106, 107, 109, 120 dhe 124 të tij si dhe në Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të A.K.E.P “Për miratimin e dokumentit me Rregulla për “Termet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike” dhe publikimin e qëndrimit të AKEP mbi komentet e palëve të interesit” në lidhje me kontratën e pajtitimit, mënyrën e hartimit, organin që e harton, përcaktimi i rregullave shtesë, e drejta e pajtimitarëve për t’u ankuar, detyrimin për verifikim të sipërmarrësit, të drejtën e pajtimitarit përju drejtuar Gjykatës..
- c) Në dy vendimet gjyqësore me objekt “Zgjidhje martesë dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj”,⁸ gjyqtari identifikon dhe/ose citon nenet 2, 6, 132, 133, 134, 136, 145-162 dhe 210 të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve, si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej.
- d) Në vendimin me objekt “Detyrimin për shlyerjen e dëmit pasuror të shkaktuar si rezultat i humbjes së armatimit”⁹ gjyqtari identifikon nenet 608, 609 dhe 640 të K. Civil në lidhje me dëmshtëpërblimin pasuror si dhe nenet 8 dhe 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në lidhje me legjitimitimin aktiv si edhe VKM nr. 275, datë 25.06.1992 "Per rregullat e administrimit e kontrollit te armeve per personat fizik e juridik" në lidhje me regjimin e veçantë të armëve të zjarrit.
- e) Në vendimet me objekt “Konstatimin e pasaktësisë në të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe detyrimin për të bërë korrigjimet e duhura” dhe “Ç’regjistrim i certifikatave të pronësisë nga BM dhe regjistrimin në favor të GH etj”, gjyqtari identifikon

⁶ Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁷ Vendimi nr.5016, datë 22.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁸Vendimi nr.253-58, datë 09.03.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ; Vendimi nr. 946-254, datë 14.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁹ Vendimi nr. 121-33, datë 15.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

nenin 32/c të K.Pr. Civile¹⁰ në lidhje me padinë e pavërtetësisë së një dokumenti si dhe nenet 6, 30, 43 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”¹¹.

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si më zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht identifikohet:

- a) Nenet 35/3, 36/1, 42, 43, 45, 46, 47/1, 51, 52 dhe 53 të K.Pr. Civile në lidhje me juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore dhe tokësore¹²
- b) Nenet 6, 16/1, 17 dhe 28 të K.Pr. Civile në lidhje me detyrën e gjykatës për të zgjidhur mosmarrëveshjet në përputhje me ligjin, për t’u shprehur vetëm për atë që kërkohet, pa i kaluar kufijtë e kërkimit si dhe nenet 253, 254 të K.Pr.Civile në lidhje me fuqinë provuese të akteve zyrtare të dala nga nëpunësit e shtetit¹³;
- c) Nenet 227 të K.Pr. Civile në lidhje me kryerjen e aktit të ekspertimit¹⁴;
- d) Nenin 317 të K.Pr. Civile në lidhje me vendimet për ekzekutim të përkohshëm¹⁵.

Përgjithësisht gjyqtari e merr në shqyrtim juridiksionin dhe kompetencën lëndore dhe tokësore në vendimet civile, por jo tek të gjitha vendimet.

Krahas dispozitave të Kodit Civil dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar në:

- Vendimin Unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 të Gjykatës së Lartë dhe Vendimin nr. 16/2011, nr. 468/2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të njëanshme dhe afatet e njoftimit¹⁶.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- a) Konkretisht, identifikohet neni 291 të K.Penal në lidhje me akuzën “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”¹⁷; neni 236/2 i K.Penal në lidhje me akuzën për kryerjen e veprave penale “*Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik*”¹⁸; neni 284/1 i K.Penal në

¹⁰ Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; Vendimi nr. 881-237, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹¹ Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹² Vendimi nr. 946-254, datë 14.09.2016; Vendimi nr.253-58, datë 09.03.2016; Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016; Vendimi nr.5016, datë 22.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹³ Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹⁴ Vendimi nr. 946-254, datë 14.09.2016; Vendimi nr.253-58, datë 09.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹⁵ Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

¹⁶ Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

¹⁷Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹⁸ Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

lidhje me akuzën e “*Kultivim i bimëve narkotikëve*”¹⁹; neni 278/2/3 i K.Penal në lidhje me akuzën e “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit*”²⁰, nenin 199/a/1 i K.Penal në lidhje me akuzën “*Ndëtim i paligjshëm*” në tokën e vet²¹ dhe nenin 134/2 në lidhje me akuzën e “*Vjedhjes më shumë se njëherë*”²²;

- b) Nenet 1/b, 1/c të K. Penal në lidhje me parimet mbi të cilat mbështet legjislacioni penal si dhe nenin 17/1 të Kushtetutës në lidhje me dënimin penal i cili duhet të jetë i drejtë dhe në përpjestim me veprën penale;²³
- c) Në ato raste kur për cilësimin juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij, nevojitet referimi në ligje të tjera organike, identifikohet ligji organik përkatës. Konkretisht, në analizën e anës objektive të figurës së veprës penale të “*Ndëtim i paligjshëm*”, gjyqtari referon në Ligjin nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” konkretisht në nenet 3, 39, 41, 43 dhe 52 në lidhje me konceptet ndërtimit pa leje, lejes së ndërtimit, rregullores së ndërtimit²⁴. Ndërsa në analizën e anës objektive të veprës “*Drejtim të automjetit në mënyrë të parregullt*”, duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtari referon nenin 115 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.²⁵
- d) Referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit, aplikimin e alternative të dënimit apo edhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, bashkimin e dënimeve (*nenet 47, 48, 49, 50, 55, 59, 60, 63 të K.Penal*)²⁶, tentativën²⁷ (*neni 22 i K.Penal*) dhe dënimin e të miturit (*neni 51 i K. Penal*)²⁸.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtari referon, si pjesë e integruar e arsyetimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal:

- a) Nenet 13/3, 69/1, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale në lidhje me juridiksionin, kompetencën tokësore dhe lëndore dhe përbërjen e trupit gjykues me një anëtar²⁹;

¹⁹ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁰ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²¹ Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²² Vendimi nr.490, datë 13.03.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²³ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁴ Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁵ Vendimi nr.1038-181, datë 03.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁶ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁷ Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁸ Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

²⁹ Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr.1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

- b) Nenet 251 dhe 252 të K.Pr.Penale në lidhje me arrestimin në flagracë dhe 228, 229, 238 dhe 245/1 të K. Pr. Penale në lidhje në lidhje me kriteret e caktimit të masës së sigurimit personal, afatin e caktimit të kësaj mase³⁰;
- c) Nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit 31;
- d) Neni 152/2 i K.Pr. Penale në lidhje me indicjet dhe faktet që nxirren prej tyre³²;
- e) Nenet 190/1 në lidhje me provat materiale dhe nenet 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet gjyqësore në procesin penal³³;

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar në:

- Vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë thuajse sa herë që ka vendosur për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe Vendimin nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me gjykimin e shkurtuar³⁴;
- Vendimin Unifikues nr. 4, datë 14.11.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me dyshimin e arsyeshëm, Vendimin Unifikues nr. 7/2011 në lidhje me kuptimin e termit «rrezik»³⁵.
- Vendimet nr. 19/2011, nr. 1/2011 të Gjykatës Kushtetuese³⁶ në lidhje me riedukimin si synim i sanksionit penal, parimin e humanizmit dhe Vendimin nr. 28/2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me dënimin me burg si masë e fundit, ku çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme³⁷.
- Vendimin nr. 26/2006 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me organin që ushtron ndjekjen penale ; vendimin nr. 85/2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me përputhshmërinë e indicjeve³⁸ ;

³⁰ Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³¹ Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

³² Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³³ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁴ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁵ Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁶ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁷ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 ; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁸ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- Vendimin Unifikues nr. 5/2003 në lidhje me kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë në vjedhjen e pasurisë, Rekomandimin 2008 (11) të Komitetit të Këshillit të Ministrave të KE në lidhje me sanksionet dhe masat e zbatuara mbit ë miturit, Rregullat e Pekinit, Rregullat e Havanës³⁹.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

Në kundërshtimet e tij gjyqtari, duke kërkuar pikëzimin maksimal për këtë tregues pretendoj se disa nga mangësitë e konstatuara në projektraport, lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes nuk qëndrojnë dhe nuk janë të tilla, që tregojnë nivel mbi mesatar për këtë tregues.

KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizës e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe në disa raste të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “mbi mesatare”, dhe pikëzohet me 20 pikë.

³⁹ Vendimi nr.490, datë 13.03.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, vlerësuesi nuk është shprehur lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përgjithësisht bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Por jo gjithmonë konstatohet një analizë e tillë, pasi në disa raste, gjyqtari nuk bën një interpretim abstrakt të normës konkrete të referuar në në disa raste ben vetën intepretim abstrakt të normës pa bërë një në raport me faktet konkrete të çështjet. Normat ligjore përmenden ose citohen duke u shoqëruar përgjithësisht me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Gjyqtari, në disa vendime burim vlerësimit, sidomos tek vendimet e zgjedhura prej tij, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Por nuk i kushton të njëjtën rëndësi arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, të cilat jo gjithmonë shoqërohen me interpretim të ligjit konkret apo me interpretimin e normave në funksion të rrethanave të çështjet.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm***

(i) Në vendimet civile: Në të gjitha vendimet e analizuara përgjithësisht konstatohet interpretimi i disa normave juridike në aspektin abstrakt të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin,

funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, duke i rënditur në çdo rast. Ndërsa nuk konstatohet gjithmonë një analizë e tillë në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari:

- a) Në vendimin me objekt “Dëmshpërblimin për zgjidhje të marrëdhënieve të punës”⁴⁰, interpreton nenin 12 të K.Punës në lidhje me kontratën e punës dhe elementët që duhet të përmbajë ajo dhe nenin 21 të K.Punës në lidhje me ndryshimin e kontratës së punës kur ajo lidhet me gojë. Gjyqtari interpreton nenin 141 të K.Punës në lidhje me parashikimet që bën ligji për rastet e përfundimit të kontratës me afat të pacaktuar sëbashku me nenin 146 të K.Punës kur kontrata zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme. Gjyqtari bën një analizë të nenit 143 (afatet e njoftimit) dhe 144 (procedura e zgjidhjes së kontratës së punës) duke bërë dallimin midis dy llojeve të zgjidhjes së kontratës së punës me apo pa shkaqe të arsyeshme duke vazhduar me analizën e nenit 153 lidhur me shkaqet e arsyeshme dhe nenit 155/3 lidhur me përgjegjësinë që lind për punëdhënësin për shpërblimin e dëmit që i shkaktohet punëmarrësit në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës në kundërshtim me ligjin. Gjyqtari merr gjithashtu në analizë në mënyrë sintetike nenin 145 të K. Punës në lidhje me shpërblimin për vjetërsi.
- b) Interpreton nenin 132 të K. Familjes në lidhje me kërkesën për zgjidhje të martesës bërë nga njëri bashkëshort dhe shkaqet mbi të cilat kërkohet zgjidhja. Gjyqtari analizon rastet kur jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë humb funksionin e saj duke mbetur thjesht një akt formal. Edhe pse nuk i referohet një neni të caktuar, Gjykata mban parasysh pasojat që sjell zgjidhja e martesës në rastin kur nga ajo kanë ardhur në jetë fëmijë që janë minore në kohën e zgjidhjes së martesës. Në këto kushte gjyqtari i referohet dhe zbaton nenet 2, 6 dhe 155 të K. Familjes që lidhet me thirrjen e psikologut, për të marrë një mendim të specializuar se cilit prind duhet t’i lihen fëmijët për rritje dhe edukim.⁴¹ Si dhe nenet 156 dhe 157 të K. Familjes në lidhje me marrëvjeshjen e bërë nga ish-bashkëshortët duke konkluduar se gjykata nuk mund ta miratojë sepse bashkëshortët i janë drejtuar gjykatës me një kërkesëpadi dhe jo me një kërkesë.⁴²
- c) Citon nenet 608, 609 dhe 640 të K. Civil në lidhje me dëmshpërblimin pasuror, por pa bërë një analizë të këtyre dispozitave. Në këtë rast analiza e gjyqtarit fokusohet tek parimi i procesit civil në rastin e përcaktimit të fajësisë, fajësi e cila prezumohet, duke theksuar ndryshim nga procesi penal.⁴³
- f) Interpreton në mënyrë të përmbledhur dhe të ndërthurur me njëri - tjetrin nenet 6, 30, 43 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” në lidhje me përbërësit e gjendjes

⁴⁰ Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i zgjedhur nga gjyqtari.

⁴¹ Vendimi nr.253-58, datë 09.03.2016 dhe vendimi nr. 946-254, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁴² Vendimi nr.253-58, datë 09.03.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

⁴³ Vendimi nr. 121-33, datë 15.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

civile, korrjigimet dhe plotësimet e dokumentave të arkivuara dhe mënyrën gjyqësore të ndryshimet të tyre⁴⁴. Në këtë vendim gjyqtari citon nenin 32/c të K.Pr.Civile por nuk bën një interpretim për kushtet që duhet të plotësojë për të qenë përpara kësaj padie. Gjyqtari në këtë rast fokuson arsyetimin në përcaktimin e natyrës së padisë së njohjes.

- g) Në vendimet që lidhen me pasaktësi dhe ndryshim të akteve administrative⁴⁵, gjykata bën edhe një analizë të akteve administrative si fakte juridike dhe karakteristikat dalluese të tyre, konkretisht atyre të nxjerra nga ZRPP dhe ZGJC, por pa marrë në analizë dispozitën përkatëse, nenin 32/c të cituar në pjesën arsyetuese.

(ii) Në vendimet penale: Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së faktit penal, gjyqtari interpreton normën përkatëse të Kodit Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm. Interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht, konstatohet se gjyqtari interpreton teorikisht normën relevante të Kodit Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale përkatëse që i atribuohet të pandehurit, dhe në disa vendime duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, , nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Megjithatë nuk konstatohet i njëjti kujdes i gjyqtarit në disa vendime të tjera penale⁴⁶, ku gjyqtari mjaftohet vetëm me analizimin në mënyrë të përmbledhur të secilit element të veprës penale në mënyrë abstrakte, duke arritur direkt në konkluzionin përkatëse se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale për të cilën akuzohet, pa e përputhur këtë analizë me faktet dhe provat e marra në shqyrtim. Dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive të saj.⁴⁷ Gjyqtari, kur identifikon dispozita penale materiale të zbatueshme për faktin penal, të cilat janë blankete (*neni 291 dhe 199/a/1 të K.Penal*) referon respektivisht në dispozitat e K.Rrugor dhe në ligjin për “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, duke cituar dispozitat përkatëse.⁴⁸

Në të gjitha vendimet penale të marra në vlerësim analizohen në mënyrë të përmbledhur të katër elementët e figurës së veprës penale në çështjet e themelit. Në këto të fundit, gjyqtari përqendrohet më tepër në elementë të anës objektive të veprave penale, me qëllim cilësimin e saktë juridik të

⁴⁴ Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁴⁵ Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016 dhe Vendimi nr. 881-237, datë 28.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁴⁶ Vendimi nr.1038-181, datë 03.10.2016, vendimi nr.673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁴⁷Konstatohet ky interpretim në të gjitha vendimet penale themeli burim vlerësimi

⁴⁸ Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

faktit penal, të cilën në disa raste e gërsheton dhe me faktet e provuara në gjykim. Konkretisht konstatohet se gjyqtari:

- a) Interpreton në mënyrë literale nenin neni 291 të K.Penal në lidhje me veprën penale “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”⁴⁹ duke u ndalur tek elementët e saj.
- b) Interpreton dispozitën materiale (nenin 236/2 të K.Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale “*Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik*”⁵⁰ për të cilën akuzohet i pandehuri duke u ndalur tek elementët e saj;
- c) Interpreton dispozitën materiale (nenin 284/1 të K.Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale “*Kultivim i bimëve narkotikëve*”⁵¹ për të cilën akuzohet i pandehuri duke u ndalur tek elementët e saj;
- d) Interpreton dispozitën materiale (nenin 278/3 të K.Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit*”⁵², për të cilën akuzohet i pandehuri duke u ndalur tek elementët e saj, por pa ndryshuar cilësimin juridik të akuzës në veprën penale duke qenë që ishte përpara një gjykimi të shkurtuar dhe pozita e të pandehurit nuk mund të rëndohej. Gjykata konkludon se riparimi i gabimeve ose pakujdesisë në ngritjen e akuzave të lidhura me një fakt penal unik nuk duhet të sjellin mohimin e pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe tjetërsimin e rolit të gjykatës duke bërë atë të marrë rolin e akuzës.
- e) Interpreton dispozitën materiale (nenin 199/a/1 të K.Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale “*Ndëtim i paligjshëm*” në tokën e vet ⁵³ për të cilën akuzohet i pandehuri duke u ndalur tek elementët e saj.

Analizën nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e veprave penale, por në disa raste edhe në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Megjithatë siç e theksuam më lart, nuk konstatohet i njëjti kujdes i gjyqtarit në disa vendime penale, ku gjyqtari është mjaftuar vetëm me një analizë të shkurtër të katër elementëve të veprës penale, duke arritur më pas direkt në konkluzionin përkatës se i pandehuri i ka konsumuar këto elementë. Përgjithësisht konstatohet se analiza e gjyqtarit përqëndrohet në tërësi provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim duke i analizuar në tërësinë e tyre, pa u ndalur veçanërisht në secilën prej tyre dhe konkludon në cilësimin juridik të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të autorëve për veprën penale që atyre u atribuohet dhe në disa raste konstatohet se gjyqtari referon edhe aktet provuese specifike me të cilën provohen elementët e veprës penale.

⁴⁹Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁵⁰ Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁵¹ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁵² Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁵³ Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

Krahas interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse, për të cilat akuzohen të pandehurit, gjyqtari i ka kushtuar rëndësi edhe *interpretimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*. Karakteristikë e gjyqtarit është fakti se ai ndalet në analizimin e llojit dhe masës së dënimit, duke listuar dhe analizuar në disa raste:

- a) Rrethanat cilësuese të tilla si kryerja e veprës penale me dhunë ose më shumë se një herë.
- b) Fajin si element të anës subjektive të veprës penale.
- c) Mënyrën e caktimit të dënimit (nenin 47 të K. Penal). Gjyqtari analizon dhe mban parasysh kriteret e përcaktuara në këtë nen në përcaktimin e dënimit.⁵⁴
- d) Përcaktimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese duke analizuar në mënyrë të përmbledhur nenet 48/ç , 49 dhe 50/gj të K. Penal⁵⁵
- e) Analizimin e pezullimit e ekzekutimit të vendimit të dënimit, duke interpretuar nenet 59 dhe 60 të K.Penal, si formë alternative të vuajtjes së dënimit duke analizuar elementët thelbësorë të aplikimit të tij, si dhe duke e aplikuar në raport me rrethanat e rasti konkret⁵⁶. Në vendimin me objekt “Vjedhje me shumë se njëherë” gjyqtari i bën një analizë shumë të hollësishme rëndësisë së aplikimit të alternativave të dënimit me burgim tek të miturit duke u ndalur në nenin 59 të K. Penal. Gjyqtari në dhënien e dënimit referon standardet ndërkombëtare duke iu referuar “Rregullave standard minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur” (Rregullat e Pekinit) si dhe “Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve i është hequr liria” (Rregullat e Havanës) duke theksuar nevojën e fëmijës për t’u riintegruar, për programe edukuese dhe për të mbajtur kontakte me familjen.
- f) Tentativën (*neni 22 i K.Penal*) dhe kushtet që duhen përmbushur njëkohësisht që vepra penale të quhet e mbetur në tentativë⁵⁷.
- g) Parimet mbi të cilat mbështet legjislacioni penal (neni 1/b, 1/c i K. Penal dhe nenin 17/1 të Kushtetutës) në lidhje me dënimin penal i cili duhet të jetë i drejtë dhe në përpjestim me veprën penale⁵⁸. Kështu, dënimi duhet nga njëra anë të ndëshkojë dhe nga ana tjetër të parandalojë sjelljet kriminale të të dënuarit dhe ta riedukojë atë.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtari përgjithësisht i jep rëndësi dhe interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por

⁵⁴ Në të gjitha vendimet penale të themelit

⁵⁵Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁵⁶ Në të gjitha vendimet e themelit përveç Vendimit nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

⁵⁷ Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵⁸ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel por edhe këtu konstatohet se gjyqtari nuk analizon në të gjitha rastet çështjet e procedurës megjithëse mund të ketë rezultuar e nevojshme. Konkretisht gjyqtari analizon:

- a) Nenin 32/c të K.Pr. Civile⁵⁹ në lidhje me padinë e pavërtetësisë së një dokumenti, ku në këtë rast analizon padinë negative ku gjykata thekson se personi i interesuar nuk ka nevojë të ftojë apo detyrojë dikë për të ngritur këtë padi por mund ta bëjë vetë një gjë të tillë duke kërkuar nga gjykata njohjen e ekzistencës ose mosekzistencës së një marrëdhënie.
- b) Në vendimin penal me objekt “Vleftësimi si i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit “arrest me burg” me afat 30 ditë”, gjyqtari interpreton shkurtimisht nenet 228, 229 dhe 245/1 të K. Pr. Penale në lidhje në lidhje me kriteret e caktimit të masës së sigurimit personal, afatin e caktimit të kësaj mase, duke i ndalur veçanërisht tek standardi që duhet të ketë dyshimi i arsyeshëm, duke i analizuar në këtë rast edhe në raport me rrethanat dhe faktet e provuara në gjykim⁶⁰;
- c) Në vendimin penal me objekt “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, gjyqtari interpreton në mënyrë të hollësishme konceptin e indicjeve (neni 152/2 i K.Pr.Penale) dhe fakteve që nxirren prej tyre në mbështetje të të cilit referon Vendimin nr. 85/2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- d) Në çështjet penale të themelit gjyqtari interpreton në mënyrë sintetike dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të tij në lidhje me vlerësimin lidhur me kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar (*neni 403, 404, 406 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*Vendimin nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Vendimin nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese*).⁶¹

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.***

Në vendimet e analizuara rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë*), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë thaujse sa herë që ka vendosur për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe Vendimin nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me gjykimin e shkurtuar⁶²;

⁵⁹ Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ; Vendimi nr. 881-237, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁰ Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶¹Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr. 1038-181, datë 03.10.2016 ; Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

⁶² Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- Vendimin Unifikues nr. 4, datë 14.11.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me dyshimin e arsyeshëm, Vendimin Unifikues nr. 7/2011 në lidhje me kuptimin e termit «rrezik»⁶³ ;
- Vendimet nr. 19/2011, nr. 1/2011 të Gjykatës Kushtetuese⁶⁴ në lidhje me riedukimin si synim i sanksionit penal, parimin e humanizmit dhe Vendimin nr. 28/2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me dënimin me burg si masë e fundit, ku çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme⁶⁵ ;
- Vendimin nr. 26/2006 të gjykatës Kushtetuese në lidhje me organin që ushtron ndjekjen penale ; vendimin nr. 85/2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me përputhshmërinë e indicjeve⁶⁶ ;
- Vendimin Unifikues nr. 5/2003 në lidhje me kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë në vjedhjen e pasurisë, Rekomandimin 2008 (11) të Komitetit të Këshillit të Ministrave të KE në lidhje me sanksionet dhe masat e zbatuara mbit ë miturit, Rregullat e Pekinit, Rregullat e Havanës⁶⁷ ;
- Vendimin e GJEDNJ në lidhje me dyshimin e arsyeshëm⁶⁸ ;
- Vendimin Unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 të Gjykatës së Lartë dhe Vendimin nr. 16/2011, nr. 468/2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të njëanshme dhe afatet e njoftimit⁶⁹ ;
- Vendimin nr. 292/2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën ; Vendimin Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me përcaktimin e objektit të padisë⁷⁰.

-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, citon dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës herë duke i përmendur ato shprehimisht, herë duke iu referuar kontekstit të arsyesimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtari njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e mirëbesimit* mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në kuadër të analizës lidhur

⁶³ Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁴ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁵ Vendimi nr.52-08, datë 22.01.2016 ; Vendimi nr.90-21, datë 02.02.2016 ; Vendimi nr.490, datë 13.03.2014 ; Vendimi nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁶ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁷ Vendimi nr.490, datë 13.03.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁸ Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶⁹ Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

⁷⁰ Vendimi nr.5016, datë 22.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës si dhe *parimin e mbrojtjes së punëmarrësit*, në kuadër të analizës në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.

- *Parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës në vendimet familjare*, analizën e të cilit gjykata e bën nën interpretimin e dispozitave familjare.
- *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit në të cilat gjyqtari analizon domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për përgjegjësinë penale të të pandehurit për faktin penal që i atribuohet.
- Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, *si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimi i humanizmit*. Në kuadër të zbatimit të këtyre parimeve, gjyqtari në të gjitha vendimet penale të themelit, përcakton dhe individualizon dënimin për të pandehurin duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 e vijues të Kodit Penal dhe nenin 17/1 të Kushtetutës dhe duke analizuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të të pandehurit.

Edhe për këtë tregues gjyqtari paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal, duke pretenduar se arsyetimi i vendimit përfundimtar i është kushtuar vëmendje e duhur analizës së provave, duke arsyetuar faktin e provuar nga secila provë dhe në tërësi dhe ka vlerësuar se vendimi përfundimtar i gjykatës nuk është vendi i duhur për të kryer interpretime abstrakte që nuk i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, por interpretimi abstrakt është bërë gjithnjë në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, kur sidomos kjo normë ka vend për diskutim e ka paqartësi. Në tërësi ka vlerësuar se disa nga mangësitë e konstatuara në projektraport, lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes nuk qëndrojnë dhe nuk janë të tilla, që tregojnë nivel mbi mesatar për këtë tregues.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet civile dhe penale. Konstatohet se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe procedural, duke bërë si interpretim abstrakt të normave por edhe duke i integruar ato me provat e paraqitura, por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimin e ligjit në çështjet civile ashtu dhe në çështjet penale. Në disa vendime burim vlerësimi, interpretimi i ligjit nuk është bërë në zbatim të rrethanave dhe fakteve të provuara dhe në disa raste dispozitat janë cituar pa bërë një analizë abstrakte dhe konkrete të tyre. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ dhe standardet ndërkombëtare të drejtësisë për të mitur të sanksionuara në aktet ndërkombëtare si dhe ka treguar kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat

integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 20 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohej një liri e konsiderueshme veprimi, përta i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar⁷¹.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij përgjithësisht, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standartizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në përmbajtjen e vendimit civil gjyqtari Arapi parashtron faktet dhe rrethanat e çështjes, tregon provat prej nga rezultuan faktet ku provat jo vetëm citohen, por tregohet përmbajtja e secilës

⁷¹ Vendimi I GJEDNJ, Cështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

prej tyre. Gjyqtari Arapi në vendimet civile, parashtron pretendimet dhe prapësimet e palëve dhe i analizon ato në raport me parashikimet ligjore, jo vetëm në raport me bazën ligjore të padisë, por edhe tregon rrethi e normave ligjore të zbatueshme në rastin konkret....”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues jo jurist, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi në disa raste përshkrimi të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezultoni se në të gjitha vendimet gjyqësore janë përdorur të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

Vendimet janë të ndara me nënndarje apo nëntituj identifikues, dhe këto të fundit janë të ndarë në paragrafë. Por jo gjithmonë konstatohet se paragrafët kanë lidhje logjike me njëra tjetrën duke e bërë vendimin jo gjithmonë lehtësisht të kuptueshëm. Kjo pasi konstatohet se mendimi juridik kalon nga një pjesë në tjetrën e më pas kemi përsëritje të analizës së koncepteve juridike apo paragrafë që duken të futura në një pjesë që ndërpresin rrjedhën logjike analizës.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, por gjithmonë të kuptueshme edhe në shqip.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për përzgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke pasur në vëmendje respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit.

Gjyqtari përgjithësisht përdor fjali me gjatësi mesatare dhe disa herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi në pjesën përkatëse,

pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë dhe paragrafët e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës, ndërsa nuk konstatohet e njëjta rrjedhë logjike ndërmjet paragrafëve të arsytimit të vendimit. Vendimi është i organizuar në tituj (ndonjëherë edhe në nëntituj në varësi të kompleksitetit të çështjes) dhe me paragrafë, shpesh të numërtuar, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër, të cilët përgjithësisht lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike, hyrëse, të cilat e bëjnë shumë të lehtë leximin e organizuar. Kjo mënyrë organizimi është më e qartë tek vendimet e zgjedhura prej gjyqtarit, ndërsa tek disa vendime të zgjedhura me short nuk konstatohet e njëjta qartësi, pasi jo gjithmonë paragrafët vijnë si rrjedhë logjike midis tyre.

Në disa vendime përfundimtare burim vlerësimi gjyqtari pasqyron elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre ndërsa në disa vendime nuk konstatohet të pasqyrohen këto elementë, çka tregon se jo të gjitha vendimet e gjyqtarit ndjekin të njëjtin logjikë arsytimi. Në vendimet burim vlerësimi përgjithësisht pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat përgjithësisht merren në analizë nga gjyqtari në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, herë pas here, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, duke vijuar, në disa raste në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, i jep qartësi elementëve procedurale të gjyqimit dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

Edhe për këtë tregues gjyqtari paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal, duke pretenduar se arsytimi i vendimeve të tij është i qartë, dhe se ata nuk janë copy-paste. Në arsytim ai përdor fjali me gjymtyrë të plotë, paragrafë të shkurtër me tri apo katër fjali të ndara nga njëri-tjetri për tu lexuar thjesht dhe me numra apo shkrim romak për të orientuar lexuesin.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Evidentohet një shkallë mbi mesatare e gjyqtarit në arsytimin e ligjit si në aspektin abstrakt, duke e gërshtuar me praktikën unifikuese në funksion të analizës juridike edhe me faktet e provuara, por jo gjithmonë janë të rëndituar në mënyrë llogjike të gjitha shkaqet që çojnë në një vendimarrje të caktuar.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 12 pikë.*

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Struktura është e qëndrueshme dhe e standartizuar.”*

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbytjes së vendimit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë përgjithësisht të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale (jo në të gjitha vendimet) dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmblyllje procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek përgjithësisht metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, përfaqësuesit e tyre, prezencën ose mungesën e tyre në seancë, objektin e shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objektin e kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Në disa raste në këtë pjesë është marrë në analizë edhe fakti se çështja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencën lëndore e tokësore të gjykatës.

Pjesa përshkuese-arsyetuese e vendimit përgjithësisht organizohet në një strukturë të qendrueshme, e ndarë në paragrafë të cilët përgjithësisht vijnë në rrjedhe logjike dhe e ndarë në pjesë apo nënpjesë me tituj apo me fjali hyrëse përshkuese. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *fillimisht*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e padisë me të meta duke orientuar palët të paraqesin kërkesëpadi me objekt të ri,⁷² shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar,⁷³ etj. Megjithatë në disa vendime nuk konstatohet se gjyqtari të jetë ndalur në ecurinë procedurale të çështjes.
- (ii) *faktet e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave* të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave të marra në tërësi, dhe në disa raste ndalet dhe me faktet e provuara duke referuar aktet përkatëse. Në çështjet penale burim vlerësimi, gjyqtari përshkruan në mënyrë të përmbledhur hetimin e kryer si dhe veprimet procedurale të kryera dhe përgjithësisht liston provat e marra në fazën e hetimit, nga momenti i ngjarjes (faktit penal) deri në momentin e dërgimit të çështjes për gjykim nga prokuroria, duke i cituar në disa raste dhe faktet që kanë rezultuar nga secila prej tyre.
- (iii) *analizën ose vlerësimin ligjor të gjykatës (edhe pse në vendime nuk gjendet me këtë titull)* lidhur me çështjen. Në disa vendime burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale, ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, është pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës. Në pjesën tjetër të vendimeve, penale ose civile, gjyqtari organizon pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit duke nisur kryesisht me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të konkluzionit e për të vijuar më pas dhënien e konkluzionit mbi bazueshmërinë ose jo të kërtimeve objekt padie apo kërkesës penale. Ndërkohë, në disa çështjet penale të themelit, analiza ligjore organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zberthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përjasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, dhe në disa raste bëhet vetëm analiza e elementëve të veprës penale në mënyrë abstrakte, pa bërë përjasjen me faktet konkrete të çështjes, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit, dhe më tej me analizën në një pjesë më vetë, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Sikurse u tha më lart, gjyqtari i kushton më shumë rëndësi analizës së llojit dhe masës së dënimit.

⁷² Vendimi nr.881-237, datë 28.07.2016 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

⁷³Në të gjitha vendimet penale themeli

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike (*vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrestit me burg”*), dënimit dhe masën e dënimit, llogaritjen e dënimit, mënyrën e ekzekutimit të tij, disponimi mbi provat materiale, masat e sigurimit si dhe shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 251 të K.Pr.Penale, në vendimin për arrestimin në flagrancë, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukturë të mirë organizuar të vendimit (megjithëse nuk konstatohet e njëjta strukturë në të gjitha vendimet burim vlerësimi), e cila është e dukshme në aspektin e përmbajtjes dhe atë vizual, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë përgjithësisht të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNj-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i

mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.⁷⁴

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në përmbajtjen e vendimit civil gjyqtari Arapi parashtron faktet dhe rrethanat e çështjes, tregon provat prej nga rezultuan faktet ku provat jo vetëm citohen, por tregtohet përmbajtja e secilës prej tyre. Gjyqtari Arapi në vendimet civile, parashtron pretendimet dhe prapësimet e palëve dhe i analizon ato në raport me parashikimet ligjore, jo vetëm në raport me bazën ligjore të padisë, por edhe tregon rrethi e normave ligjore të zbatueshme në rastin konkret...Në vendimet penale, gjyqtari Arapi, i kushton rëndësi kualifikimit të saktë të veprës penale atribuar të pandehurit, duke marrë në analizë dispozitën përkatëse të K. Penal që e parashikon atë vepër në të katër elementët e figurës së veprës penale...”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet e analizuara rezulton përgjithësisht një nivel i mirë arsytimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar përgjithësisht elementët që gjyqtari ka vlerësuar si të rëndësishme apo të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe elementët e vlerësuar të nevojshëm për tu analizuar në raport me aspektet procedurale.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përshkrimit të fakteve të çështjes me natyrë procedurale dhe materiale përgjithësisht zhvillohet mbi bazën e një analize logjike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal, të zbatueshëm, duke integruar këto elementë në shumicën e rasteve edhe me faktet e çështjes të provuara në gjykim, duke referuar edhe aktet provuese të vlerësuar të rëndësishme, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të tij për zgjidhjen e çështjes dhe vlerësimit për bazueshmërinë ose jo të kërtimeve të palëve.

Në disa vendime burim vlerësimi, rezulton kujdes i gjyqtarit për të identifikuar dhe analizuar koncepte ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur

⁷⁴ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

me zgjidhjen e çështjes, duke u marrë edhe me trajtimin juridik të koncepteve të së drejtës, duke orientuar me pas analizën e faktit dhe të ligjit në funksion të mbështetjes së konkluzioneve lidhur me bazueshmërinë ose jo të padisë, të kërkimeve të palëve në çështjet penale. Në pjesën tjetër të vendimeve burim vlerësimi nuk rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore të koncepteve dhe të dispozitave të zbatueshme si ato me karakter procedural dhe material, megjithëse janë cituar nga gjyqtari, dhe në aspektin e argumentimit logjik, pasi komponenti analitik bazohet vetëm në arritjen e konkluzionit përkatës pa e analizuar atë në raport me rrethanat dhe faktet konkrete të përshkruara përgjithësisht në mënyrë të qartë në pjesën e parë të vendimit, dhe si gjejnë zbatim dispozitat përkatëse në raport me rrethanat konkrete të çështjes. Në disa raste nuk bëhen një analizë juridike e koncepteve apo dispozitave përkatëse që gjejnë zbatim, por konkludohet direkt bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, dhe në disa raste konstatohet se bëhet një analizë e shkurtër e koncepteve juridike, por ato nuk analizohet në raport me rrethanat e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak-pasojë, megjithëse referuar rrethanave dhe fakteve ka qenë e nevojshme të analizohet, duke bërë kështu që vendimi jo gjithmonë të jetë vijë si një i tërë në rrjedhë logjike.

Arsyetimi i vendimeve gjyqësore përgjithësisht është i qartë dhe i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqese duke i analizuar ato, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, në tërësi si pjesë e analizës tërësore mbi zgjidhjen e çështjes. Por në disa vendime, arsyetimi jo gjithmonë është i qartë dhe i plotë edhe në raport me analizimin e të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve si në aspektin e analizës juridike të koncepteve ashtu edhe në raport me rrethanat dhe faktet konkrete të çështjes, ku gjyqtari pas një analize të përmbledhur të koncepteve lidhur me padinë apo barrën e provës, apo të elementëve të veprës penale, del direkt në konkluzionin përkatës lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes në themel.

Në disa vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore përgjithësisht zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime, lidhur me:

- analizën e koncepteve ligjore (*nëse kontrata e punës së paditësit ka qenë me apo pa afat, nëse mënyra e përfundimit të marrëdhënies së punës ka qenë normale apo e jashtëzakonshme, procedura në zgjidhjen e kontratës së punës etj.*);⁷⁵
- analizën e koncepteve ligjore (*mbi institutin e martesës dhe zgjidhjen e saj, pasojat ligjore të zgjidhjes së martesës me karakter vetjak si dhe pasojat ligjore me fëmijët*) megjithëse

⁷⁵Vendimi nr.838-220, datë 18.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

*në lidhje me pasojat nuk është bërë një analizë në raport dhe me provat e paraqitura,*⁷⁶

- analizën e konceptit të dyshimit të arsyeshëm si kusht i domosdoshëm, por jo i vetëm për caktimin e masës së sigurimit⁷⁷;
- analizën e konceptit të akteve administrative si fakte juridike të nxjerra nga Zyra e Gjendjes Civile që preken nga nga pasaktësi apo gabime materiale⁷⁸;
- analizën e konceptit të indicjes për të arritur në konkluzionin se në raste përjashtimore indicjet mund të provojnë ekzistencën e një fakti (kur janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën)⁷⁹;
- analizën e katër elementët e figurës së veprës penale (*në vendimet penale themeli*), në arritjen e konkluzionit mbi përgjegjësinë penale të autorëve. Megjithatë kjo analizë konstatohet se në disa vendime është bërë vetëm në mënyrë abstrakte, pa u analizuar në raport me rrethanat e çështjes dhe aktet provuese ku bazohet, duke arritur direkt në konkluzionin përkatës lidhur me fajësinë e të pandehurit për veprën për të cilën është akuzuar⁸⁰. Në të gjitha vendimet penale konstatohet se gjyqtari, ndalet në llojin e dënimit, rrethanat lehtësuese apo rënduese për të pandehurit duke individualizuar dënimin për secilin prej tyre. Ndërsa në një vendim penal, ku vepra penale është kryer në bashkëpunim, gjyqtari nuk ka individualizuar dënimin për secilin prej tyre në veçanti, por i ka analizuar të dy së bashku⁸¹. Në shumicën e rasteve, konstatohet se gjyqtari analizon dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit si alternativë dënimi, kur është paraqitur një kërkesë e tillë, duke analizuar kriteret ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.⁸²

Në disa vendime interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsytimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet ku i kushtohet më shumë rëndësi anës objektive, ecurinë procedurale të gjykimit, kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit, kushteve dhe kriterëve ligjore të aplikimit të masave të sigurimit personal, aplikimi të alternativave të dënimit me burgim dhe qëllimit të aplikimit të tyre në raport me arritjen e qëllimit të dënimit penal apo zbatimin e parimit

⁷⁶Vendimi nr.253-58, datë 09.03.2016 ; Vendimi nr. 946-254, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

⁷⁷Vendimi nr.668/115, datë 09.06.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁷⁸ Vendimi nr. 881-237, datë 28.07.2016 ; Vendimi nr. 702/179, datë 21.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁷⁹ Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁸⁰ Vendimi nr.1038-181, datë 03.10.2016, vendimi 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁸¹ Vendimi nr.673-110-124, datë 10.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁸²Në të gjitha vendimet penale themeli përveç në Vendimi nr. 1172-228, datë 09.11.2015 dhe në vendimin nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku në këtë të fundit është marrë në analizë vetën kërkesa e një të pandehurit ndërsa për të pandehurin tjetër gjyqtari nuk ka bërë asnjë analizë për pranimin ose jo të kësaj kërkesë.

të caktimit të dënimit në mënyrë të drejtë dhe proporcionale. Por siç e theksuam më sipër, një analizë e tillë nuk konstatohet në të gjitha vendimet gjyqësore, si tek vendimet penale ashtu edhe tek vendimet civile. Në këto vendime, gjyqtari përgjithësisht ben një analizë të shkurtër të dispozitave që gjejnë zbatim në rastin konkret, por edhe kjo nuk konstatohet tek të gjitha vendimet, dhe mungon analiza e koncepteve juridike dhe e dispozitave që gjejnë zbatim në raport me rrethanat konkrete dhe provat e administruara në gjykim, në shërbim të arritjen së konkluzionit përkatës për të cilën gjyqtari ka disponuar⁸³.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në pjesën më të madhe të vendimeve gjyqësore burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.) apo janë pjesë e analizës ligjore, duke u identifikuar në mënyrë të veçantë në pjesën arsyetuese të vendimit. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsytimit ligjor dhe në disa raste kur kërkimet kanë qenë të shumta, në një pjesë të veçuar të arsytimit (por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret), pretendimet e palëve në disa raste kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor. Por në disa raste konstatohet se këto kërkime nuk kanë marrë një përgjigje të argumentuar, si në aspektin ligjor ashtu dhe bazuar në provat e marra në shqyrtim.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari paraqiti kundërshtime, duke kërkuar pikëzim maksimal, duke pretenduar se vendimet nuk janë copy – paste i njëra tjetrës por ndryshojnë dhe se ai kujdeset që vendimi të jetë i mirëstrukturuar, i qartë dhe llogjik, të pasqyrojë faktet kyçe, rregullat e së drejtës materiale dhe procedurale të zbatueshme dhe në analizën dhe arsytimin, që përban të mos jetë i dykuptimtë, të mos shtrembërojë faktet dhe ligjin, për të krijuar bindjen dhe detyrim për palët në proced dhe mundësi kontrolli nga gjykatat më të larta. Në arsytim ai zbaton rregullat e logjikës formale të induksionit e deduksionit, përdor kundëranalizën, ballafaqoj faktet me njëra- tjetrën dhe me ligjin dhe në përfundimet e arritura për të qenë i kuptueshëm, konkret, detyrues dhe të ekzekutueshëm nga ana e zyrave të përmarimit gjyqësor shtetëror ose privat.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport me natyrën çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi mesatare në

⁸³ Vendimi nr.881-237, datë 28.07.2016, vendimi nr.703-179, datë 21.06.2016, vendimi nr.121-33, datë 15.02.2016, vendimi nr.1038-181, datë 03.10.2016, vendimi nr.673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në disa vendime burim vlerësimi, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe në disa raste janë referuar edhe qëndrime të praktikës gjyqësore, megjithëse nuk spikat interpretimi individual i ligjit. Përgjithësisht gjyqtari i kushton rëndësi në analizë të pretendimeve të palëve, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjen e procedurës ashtu dhe për themelin e zgjidhjes së saj. Megjithatë, duke i vlerësuar vendimet burim vlerësimi në tërësinë e tyre, nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizë dhe argumentit logjik, si në lidhje me çështjet e procedurës ashtu dhe të themelit, pasi në një pjesë të vendimeve mungon komponenti analizës juridike të ligjit të zbatueshëm, dhe në disa vendime megjithëse i është bërë një analizë koncepteve të së drejtës apo të ligjit të zbatueshëm, mungon ndërthurja e këtyre koncepteve dhe interpretimi i ligjit të zbatueshëm në raport me mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet konkrete. Gjithashtu edhe pse konstatohet se disa vendime janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkesat e palëve, të cilat marrin përgjigje, kjo e fundit jo gjithmonë bazohet në një vlerësim të pavarur të pretendimeve të ngritur bazuar në ligjin përkatës që gjen zgatim dhe faktet konkrete të çështjes, duke dalë direkt në konkluzionin për bazueshmërinë ose jo të kërimit përkatës në çështjet civile dhe penale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “mesatar” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”.

AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
77	Shumë mirë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se :” Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor (shih dosjen 2), ose afati standard standard i gjykimit (shih dosjet 1, 3, 4 dhe 5).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga Gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu edhe për çështjet civile të themelit, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor në Kodin e Procedurës Civile për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga Gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për shqyrtimin e çështjes. Konkretisht;

- (i) Çështja e kategorisë «kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake», me objekt *vleftësim arresti i ligjshëm dhe caktim mase sigurimi*, për të cilën është parashikuar si afat ligjor afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykate, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Referuar

dosjes që i përket vendimit nr. 668-115, date 09.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 08.06.2016 ora, 15.09 min dhe datë vendimi datën 09.06. 2016. **Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/2 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**

- (ii) Çështja e kategorisë »kërkesë penale në « fazën e hetimeve paraprake », me objekt, *vleftësim arresti i ligjshëm dhe caktim mase sigurimi*, e gjykuar me pas me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë sipas nenit 400 e vijues të K.Pr.Penale, për të cilin është parashikuar si afat ligjor, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Referuar dosjes që i përket vendimit nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 03.06.2016 ora, dhe datë vendimi për vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flangrancë dhe caktim mase në datë 04.06.2016, ku në të njëjtën vendim, gjykata ka vendosur zhvillimin e gjykimit të drejtpërdrejtë për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit. **Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/2 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor gjykimi, duke iu referuar dy çështjeve të analizuar më sipër në të cilën afati ligjor i gjykimit është respektuar dhe prezumimit se në mungesë të të dhënave të tjera që mund të ndikojnë në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është e lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet 15 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor, është 0%.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Aurel Arapi ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 2) deri në 3 muaj e 29 dite (shih dosjen 5). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qene 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 1), një muaj e 25 ditë (shih dosjen 3) dhe 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor (shih dosjen 2), ose afati standard i gjykimit (shih dosjet 1, 3, 4 dhe 5.

Gjithashtu, përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit rezultoi, se në të tre rastet e prezantuara është respektuar afati standard i gjykimit.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për të gjitha çështjet: 10 (dhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi dhe 3 (dy) vendimet e përzgjedhura nga Gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së⁸⁴.

Konkretisht , referuar 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga vetë Gjyqtari, konstatohet se:

- (i) Vendimi civil nr. 838-220, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt të padisë: “*Dëmshpërblim nga marrëdhënia e punës.*” Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 04.05.2016 dhe datë përfundimi 18.07.2016, pra rezulton që çështja ka përfunduar brenda një afati prej **2 muaj e 14 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma “e” të vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (ii) Vendimi civil/ familjar nr. nr. 253-58, date 09.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt të padisë: “*Zjidhje martese dhe rregullimin e pasojave që vijnë nga*

⁸⁴ Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ *Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo me tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile ne Gjykatën e Shkallës së parë jo me tej se 6 muaj dhe 4 muaj gjykimet familjare me palë kundërshtare”*

- martesa*". Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 13.01.2016 dhe datë përfundimi 09.03.2016, pra rezulton që çështja ka përfunduar brenda një afati prej **1 muajsh e 26 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma "d", të vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (iii) Vendimi penal nr. 90-21, date 02.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndaj të akuzuarit S.U, akuzuar për kryerjen e veprës penale të: *"Ndërtim i paligjshëm"*, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penale. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 23.12.2015 dhe datë përfundimi 02.02.2016, pra rezulton që çështja ka përfunduar brenda një afati prej **1 muaj e 10 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 (nëntë) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma "a" të vendimit nr. 261/2 të KLD.**

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short,⁸⁵ konstatohet se:

- (i) Dosja 1- Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 52-08, date 22.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndaj të pandehurit G.P, akuzuar për veprën penale *"Kultivim i bimeve narkotike"*, parashikuara nga neni 284/1 i Kodit Penal, rezulton të jetë regjistruar në datë 09.12.2015 dhe ka përfunduar në datë 22.01.2016, brenda një afati prej **1 muaj e 13 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 (nëntë) muaj të parashikuar nga pika 5, gërma "a" e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (ii) Dosja 3- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 702/179, datë 21.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt *"Deklarim pavërtetësi shënimesh"*, rezulton të jetë regjistruar në datë 27.04.2016 dhe ka përfunduar në datë 21.06.2016, brenda një afati prej **1 muaj e 24 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma "e" e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (iii) Dosja 4- Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj të pandehurit K.Ç akuzuar për veprën penale *"Vjedhjes më shumë se një herë"*, në tre episode të mbetura në tentative, parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal", rezulton të jetë regjistruar në datë 31.01.2014 dhe ka përfunduar në datë 13.03.2014, brenda një afati prej **1 muaj e 12 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 (nëntë) muaj të parashikuar nga pika 5, gërma "a" e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (iv) Dosja 5- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. nr. 5016 datë 22.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt *"Detyrimin për kthim shume"*, rezulton të jetë regjistruar në datë 24.12.2013 dhe ka përfunduar në datë 22.04.2014, brenda një afati prej **3 muaj e 28 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma "e" e vendimit nr. 261/2 të KLD.**

⁸⁵ Sikundër kemi analizuar nga 11 çështje të përzgjedhura me short, 1 prej tyre parashikon afat ligjor dhe 10 afat standard minimal kohor për përfundimin e tyre.

- (v) Dosja 6 (1)- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 881- 237, datë 28.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “Ç’ rregjistrim i certifikatës së pronësisë etj, ”, rezulton të jetë regjistruar në datë 09.03.2016 dhe ka përfunduar në datë 28.07.2016, brenda një afati prej **4 muaj e 19 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma “e” e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (vi) Dosja 7 (2)- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 121- 33, datë 15.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “Shpërblim dëmi pasuror.”, rezulton të jetë regjistruar në datë 28.10.2015 dhe ka përfunduar në datë 15.02.2016, brenda një afati prej **3 muaj e 18 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma “e” e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (vii) Dosja 8 (3)- Çështja familjare e përfunduar me vendimin nr. 946-254, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “Zgjidhje martesë dhe rregullimin e pasojave të saj.”, rezulton të jetë regjistruar në datë 23.02.2016 dhe ka përfunduar në datë 14.09.2016, brenda një afati prej **6 muaj e 21 ditë, jashtë standardit minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma “d” e vendimit nr. 261/2 të KLD. Edhe po të zbresim periudhën e muajit gusht, gjatë së cilit gjyqtari dhe administrata gjyqësore kryen lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar brenda 5 muaj e 21 ditë, përsëri jashtë standardit minimal prej 4 muajsh.**
- (viii) Dosja 9 (4)- Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndaj të pandehurit I.M akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal”, rezulton të jetë regjistruar në datë 01.10.2015 dhe ka përfunduar në datë 09.11.2015, brenda një afati prej **1 muaj e 8 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 (nëntë) muaj të parashikuar nga pika 5, gërma “a” e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (ix) Dosja 10 (5)- Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 1038-181, datë 03.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndaj të pandehurit Ç.H, akuzuar për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të paregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal”, rezulton të jetë regjistruar në datë 24.06.2016 dhe ka përfunduar në datë 03.10.2016, brenda një afati prej **3 muaj e 9 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 (nëntë) muaj të parashikuar nga pika 5, gërma “a” e vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (x) Dosja 11 (6)- Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndaj të pandehurit E.V dhe L.V, akuzuar për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të paregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, e gjykuar me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë si dhe me gjykim të shkurtuar , rezulton të jetë regjistruar në datë 03.06.2016 dhe ka përfunduar në datë 10.06.2016, brenda një afati prej **7 ditësh, brenda standardit minimal kohor**

prej 9 (nëntë) muaj të parashikuar nga pika 5, gërma “a” e vendimit nr. 261/2 të KLD.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 12 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së. Pra në total 0 % të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” Gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të KLGJ-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e shkallës së parë në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁸⁶

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për kategori çështjesh, rezulton se :

- (i) për çështjet e kategorisë « penale themeli », kohëzgjatja e gjykimit për 6 çështje që i përket kësaj kategorie, është 1 muaj e 15 ditë, *më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj, sipas vendimit të ish KLD nr.261/2 ;*
- (ii) për çështjet e kategorisë « civile të përgjithshme me palë kundërshtare », koha mesatare e gjykimit për 5 çështjet e analizuara është 99 ditë, apo 3 muaj e 9 ditë, *më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 muaj, sipas vendimit të ish KLD nr.261/2 ;*
- (iii) për çështjet e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e gjykimit për 2 çështjet e analizuara është 128.5 ditë apo 4 muaj e 8 ditë, *më e gjatë se standardi minimal kohor prej 4 muaj, sipas vendimit të ish KLD nr.261/2 . Po të zbresim nga ky afat, muajin gusht gjatë secilës gjyqtari dhe administrata gjyqësore kryen lejen vjetore, rezulton se koha mesatare e gjykimit është 113.5 ditë apo 3 muaj e 23 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 muajsh, sipas vendimit të ish- KLD nr.261/2.*

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” Gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

⁸⁶ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ -së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Rezultoi se gjyqtari Aurel Arapi gjatë periudhës së rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në dy gjykata të ndryshme. Kështu, në periudhën 21.10.2013- gjyqtari Aurel Arapi, ka kryer stazhin profesional si kandidat për magjistrat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa nga data 25.09.2015 e në vazhdim, ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ai ka deklaruar në formularin e vetvlerësimit se në periudhën 08.10.2013-08.10.2016, i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 763 çështje, ku përfshihen gjykimet e kryera në Gjykatën e Rrethit Tiranë si stazhier, gjykimet e kryera në Gjykatën e Kurbin, dhe ato çështje ku ai është deleguar nga ish-KLD-ja në gjykata të tjera. Gjyqtari ka deklaruar në formularin e vetvlerësimit se ai ka përfunduar tre vitet e fundit 627 çështje, ndërsa ka mbartur vitin e fundit në Gjykatën e Kurbin 136 qeshtje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 82,1%.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Gjyqtari Aurel Arapi, në periudhën e vlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, ka ushtruar detyrën në dy gjykata të ndryshme. Në periudhën tetor 2013-korrik 2014, ai ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, periudhë e stazhit profesional, e cila ka filluar pas dekretimit të tij si gjyqta. Prej datës 25.09.2015 deri në datë 08.10.2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Referuar të dhënave të deklaruara nga gjyqtar si dhe të dhënave statistikore të përcjella nga dy gjykatat për efekte të organizimit të shortit rezulton se :

- (i) Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁷, gjyqtarit i janë caktuar për gjykim gjatë vitit 2013- 2014, (tetor 2013- korrik 2014) 138 çështje dhe ka përfunduar me vendim përfundimtar 120 çështje, duke mbartur 18 çështje. Referuar numrit të çështjeve të caktuar dhe numrit të çështjeve të përfunduara gjatë kësaj periudhë rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve për këtë periudhë është 87 %. Megjithatë, po të marrim parasysh faktin se gjyqtari ka qenë në pamundësi për të përfundimit të këtyre çështjeve për shkak të përfundimit të periudhës së stazhit profesional, atëherë rendimenti i përfundimit të çështjeve do të llogaritet me 100 %.

⁸⁷ Të dhënat tabelare të çështjeve të rregjistruara dhe të gjykuara nga gjyqtari Aurel Arapi për periudhën 2013-2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqe 12-13 të dosjes së rivlerësimit.

- (ii) Ndërkohë, në periudhën 2015-2016, duke e konsideruar vit kalendarik të plotë vitin 2016 si deri në datë 20.01.2017, në bazë të deklarimeve të gjyqtarit, si dhe bazuar edhe në të dhënat statistikore të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin⁸⁸, rezulton se gjatë vitit 2015- 20.01.2017 gjyqtarit i janë caktuar për gjykim 623 çështje dhe ka përfunduar 463 çështje si relator, si dhe 24 çështje në trup gjykues. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna, duke konsideruar periudhën vlerësimit deri në datë 20.01.2017, pasi deri në këtë datë kemi të dhëna, rezulton te jetë 74.4 %, dhe po të marrin edhe numrin e çështjeve të gjykuara në trup gjykues rezulton të jetë 78.17 %.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit, duke përjashtuar periudhën që Gjyqtari ka qëndruar në pritje të emërimit përfundimtar dhe nuk ka gjykuar çështje, **rezulton në masën 81 %**, përlllogaritur si mesatare e rendimentit për të dy periudhat e ushtrimit të detyrës në dy gjykata të ndryshme, e cila përkon me përqindjen e llogaritur edhe në raportin e KLGJ, përqindje e cila referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 4 pikë. Megjithatë, po të llogarisim rendimentin e përfundimit të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 100 %, rendimenti rezulton në masën e 87.2 %, e përlllogaritur si mesatare e rendimentit për të dy periudhat e ushtrimit të detyrës në dy gjykata të ndryshme, përqindje e cila referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 6 pikë

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarit Aurel Arapi, të standardit sasior në fuqi, rezulton si më poshtë vijon :

- (i) Në lidhje me periudhën që ai ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (tetor 2013-korrik 2014), z.Arapi ka qenë në periudhë stazhi dhe për pasojë ai nuk ka marrë një ngarkesë të plotë me çështje sikurse i jepet një gjyqtari me emërim definitiv. Pra Gjyqtari Aurel Arapi, për periudhën e stazhit profesional, nuk ka pasur mundësi objektive të respektojë standardin sasior të paracaktuar nga Sistemi i Vlerësimit për atë periudhë kohore. Megjithatë kjo periudhë është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, si vit shkollor, në përfundim të cilës është bërë dhe pikëzimi i tij dhe më pas rënditja përfundimtare, sipas ligjit nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në atë kohë.
- (ii) Në lidhje me periudhën që gjyqtari Aurel Arapi ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin (25.09.2015 – 08.10.2016), një periudhë gati 1 vjeçare, rezulton se gjyqtari ka përfunduar 335 çështje gjithësej si relator, nga të cilat 57 çështje penale themeli, 57 masa sigurimi personal, 49 kërkesa penale, 38 çështje civile themeli, 32 çështje familjare dhe 102 kërkesa civile, pra 128 çështje civile me palë kundërshtare. Ndërsa po ta marrin vitin kalendarik 2016 të plotë, rezulton se gjyqtari ka përfunduar 449 çështje si relator, nga të cilat 73 çështje penale themeli, 107 çështje themeli (*civile*

⁸⁸ Të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bashkëngjitur formularit të vetvlerësimit, faqe 15 e Dosjes së rivlerësimit.

të përgjithshme dhe familjare me palë kundërshtare) dhe 58 masa sigurimi, 72 kërkesa penale dhe 130 kërkesa civile (*çështje pa palë kundërshtare*) si dhe 9 çështje si gjyqtari i deleguar në gjykata të tjera. Referuar pikës 3, shkronja g) të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit ⁸⁹, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është organizuar në seksione, duhet të gjykojë jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në një vit. Në rastin konkret, Gjyqtari ka përfunduar 180 çështje themeli në një periudhë 1 vit e 3 muaj, duke gjykuar kështu nën standardin sasior sa i takon çështjeve të themeli të gjykuara.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 81 %. Po kështu sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasimore e gjyqtarit Aurel Arapi ka qenë nën standardin minimal sasior në fuqi. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 4 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”* Referuar burimeve të vlerësimit rezultoi se gjatë periudhës gati një vjeçare të vlerësimit Shtator 2015- Tetor 2016 rezulton se gjyqtari të ketë përfunduar 335 çështje gjithësej si relator, nga të cilat 57 çështje penale themeli, 57 masa sigurimi personal, 49 kërkesa penale, 38 çështje civile themeli, 32 çështje familjare dhe 102 kërkesa civile, pra 128 çështje civile me palë kundërshtare dhe 207 çështje pa palë kundërshtare, nga të cilat 57 çështje/ masa sigurimi janë me afat ligjore, ngarkesë e cila është nën standardin minimal të përcaktuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit. Gjithashtu, rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit Shtator 2015- Dhjetor 2016 ai ka qenë i deleguar edhe në gjykata të tjera ku ka përfunduar 9 çështje si relator dhe 15 çështje si anëtarë i trupit gjykues, duke e bërë atë të pamundur për të qenë në gjykatën ku ushtron detyrën në datat e zhvillimit të gjykimeve si gjyqtar i deleguar. Për sa më lartë, megjithëse nuk rezulton se gjyqtari të ketë gjykuar çështje tej standardit minimal të caktuar, pasur parasysh rrethanat e mësipërme, vlerësohet pikëzimin e tij me një nivel më të lartë, duke e pikëzuar me 6 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin *“rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”* Gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 6 pikë, pasi megjithëse gjyqtari nuk e ka kaluar asnjëherë standardin minimal, ka gjykuar edhe çështje si i deleguar në gjykata të tjera.

⁸⁹ Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve, miratuar me vendimin nr.261/2 të vitit 2010 të ish – KLD.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR PËRFUNDIMTAR

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në të pesta dosjet e vëzhguara afatet ligjore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 1 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 8 ditë nga shpallja (shih dosjen 5)”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10/ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5/ditë. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj

vendimit penal dhe afati 10/ditor i arsytimit të vendimit civil sipas parashikimeve të nenit 308/2 të K.Pr.C.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i)** Vendimi penale nr. 52-08, date 22.01.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 25.01.2016, pra 3 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor të ankimit;
- (ii)** Vendimi penale, kërkesë penale me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, nr. 668-115, date 09.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 10.06.2016, pra 1 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor të ankimit;
- (iii)** Vendimi civil nr.702/179, datë 21.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 23.06.2016, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (iv)** Vendimi penal nr. 490, datë 13.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 21.03.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor të ankimit ;
- (v)** Vendimi civil nr. 5016 datë 22.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 30.04.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile ;
- (vi)** Vendimi civil nr nr. 881- 237, datë 28.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin , rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 29.07.2016, pra 1 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile ;
- (vii)** Vendimi civil nr. 121- 33, datë 15.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 17.02.2016, pra 2 nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile ;
- (viii)** Vendimi civil/ familjar nr. 946-254, datë 14.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 20.09.2016, pra 6 (gjashtë) nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile ;
- (ix)** Vendimi penal nr. 1172-228, datë 09.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 12.11.2015, pra 3 (tre) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor të ankimit;
- (x)** Vendimi penal nr. 1038-181, datë 03.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 06.10.2016, pra 3 (tre) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar të ankimit;
- (xi)** Vendimi penal nr.673-110-124, datë 10.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 10.06.2016, pra ditën e shpalljes së vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile ;

Referuar çështjeve sipas kategorive të tyre, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar (i) për kategorinë 1 “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”, është 1 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor; (ii) për kategorinë “penale themeli”, është 3 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor dhe (iii) për kategorinë “civile të përgjithshme me palë kundërshtarë” është 3.8 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara rezulton se në tërësi koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar është më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” Gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuara.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 2), me 5 seanca (shih dosjen 1), me 3 seanca (shih dosjet 3 e 4) dhe me 6 seanca (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 15 seanca gjyqësore, nga të cilat tetë seanca kanë qenë

produktive. Pengese në 7 seanca gjyqësore joproduktive janë bere mungesat e paleve ne gjashte raste, ndersa ne nje rast seanca nuk u zhvillua pasi gjyqtari nuk ishte ne pune per shkak te nje fatkeqesie familjare. Seancat e vëzhguara konstatohet se përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por vihen re edhe raste kur seancat kanë filluar me disa minuta vonesë, por që vonesa nuk ka çuar në dështimin e seancave. Në rastet e fillimit me vonesë të seancave përgjithësisht relatohet shkaku në procesverbal (shih dosjet 1-5). Nga pesëmbëdhjete seanca të vëzhguara, tetë prej tyre janë regjistruar në audio. Regjistrimi audio është evident në gjykimin e dosjeve të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ndërsa nuk kemi seanca të mbajtura në audio në dy dosjet e gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku subjekti ka punuar si gjyqtar stazhier(emërim provizor)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 (dhjetë) prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, pasi dosja me nr.2 i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 - që i përket çështjes penale, me nr. 634-332-43 regjistri themeltar, datë 09.12.2015, përfunduar me vendimin nr. 52-08, date 22.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, në përfundim të cilës është shpallur vendimi. Një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit me arsye të përligjura.
- Dosja 3 - që i përket çështjes civile, me nr. 256-291 regjistri themeltar, datë 27.04.2016, përfunduar me vendimin nr. 702/179, datë 21.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, në përfundim të cilës është shpallur vendimi.
- Dosja 4 - që i përket çështjes penale, me nr. 995 regjistri themeltar, datë regjistri 31.01.2014, përfunduar me vendimin nr. nr. 490, datë 13.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 seanca ka qenë jo produktive, e shtyrë për mungesë të prokurorit.
- Dosja 5 - që i përket çështjes civile, me nr.20230/7007 regjistrimi, datë rregjistri 24.12.2013, përfunduar me vendimin nr. 5016 date 22.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 1 (një) seanca gjyqësore, në përfundim të cilës është shpallur vendimi.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 - Çështja civile me nr. regjistri 155-228, datë regjistrimi 09.03.2016, përfunduar me vendimin nr. 881-237, datë 28.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë kanë rezultuar joproduktive, e shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, gjyqtari është caktuar për të gjykuar një çështje në Krujë.
- Dosja 7 - që i përket çështjes civile me nr. regjistri 616-450-101-228, datë regjistrimi 28.10.2015, përfunduar me vendimin nr. 121-33, datë 15.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 6 (dy) seancë gjyqësore, nga të cilat 2 seanca kanë rezultuar joproduktive.
- Dosja 8 - që i përket çështjes civile/familjare me nr. regjistri 122-211, datë regjistrimi 23.02.2016, përfunduar me vendimin nr. 946-254, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 (katër) ka qenë jo produktive, të shtyrë për mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse dhe të ekspertit të caktuar nga gjykata të cilët kanë paraqitur kërkesë për shtyrje.
- Dosja 9 - që i përket çështjes penale me nr. 484-288 regjistri, datë regjistrimi 01.10.2015, përfunduar me vendimin nr. 1172-228, datë 09.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore të cilat kanë qenë produktive, në përfundim të cilës gjykata ka shpallur vendimin.
- Dosja 10 - që i përket çështjes penale me nr. 409-215 regjistri, datë regjistrimi 24.06.2016, përfunduar me vendimin nr. 1038-181, datë 03.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar joproduktive.
- Dosja 11- që i përket çështjes penale me nr. 358-10-198 regjistri, datë regjistrimi 03.06.2016 për vlefësimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurve LV dhe EV, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 të K.Penal, ku gjyqtari ka proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë, dhe më pas me gjykim të shkurtuar, përfunduar me vendimin nr. 673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 2 (dy) seancë gjyqësore, nga të cilat kanë qenë produktive, në përfundim të cilës gjykata ka shpallur vendimin.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 (dhjetë) çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (*penale themeli dhe civile themeli dhe familjare*) varion nga 1 deri në 7 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3.5 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përfshirë seancat përgatitore), 3.4 seanca gjyqësore në çështje penale themeli dhe 7 seanca gjyqësore në një çështje familjare (duke përfshirë seanca e pajtimit).

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 10 çështjet me palë kundërshtare të analizuar, rezulton të jetë 3.8 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se Gjyqtari ka kryer me korrektësi dhe efikasitet veprimet procedurale për vënien në lëvizje të dosjeve brenda një kohë të shkurtër nga 0 deri në 12 ditë nga momenti i caktimit të tyre me short. Rezulton se Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët apo mos zhvillimin i seancave përgatitore dhe gjyqësore për shkak të mungesës së tyre. Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se Gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në referim të nenit 158/a të K.Pr.C dhe vendimin për caktimin e seancës gjyqësore në referim të nenit 333 të K.Pr.P, dhe duke pasqyruar në këto akte në mënyrë të qartë urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile apo K.Pr.Penale. Në çështjet civile rezulton se Gjyqtari ka kryer veprime përgatitore efektive, duke disponuar për t'i lënë kohë palëve për paraqitjen e provave, për marrjen e dokumentacionit nga të tretët apo pala e paditur, gjatë veprimeve përgatitore.

Seancat gjyqësore rezultojnë se janë shtyrë për shkaqe të përligjura dhe kryesisht me kërkesë të palëve; për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse për shkaqe të përligjura; për t'i dhënë kohë ekspertit të kryejë aktin e ekspertimit, për mungesë të ekspertit për arsye të përligjura, me kërkesë të palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, për shkak të mosparaqitjes së prokurorit, për të dhënë kohë prokurorit për përgatitjen e konkluzioneve, si dhe për shpalljen e vendimit të arsyetuar në një rast. Nga të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara, vetëm në një rast seanca nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit me arsye të përligjura dhe në një rast për shkak të qenies së tij në një gjykatë tjetër për shqyrtimin e një çështje si gjyqtar i deleguar.

Në çdo rast të shtyrjes së seancave gjyqësore, seanca vijuese është planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve relativisht të shkurtra, si dhe duke respektuar në çdo rast afatin procedural 5 ditor kur seanca është shtyre për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 305 të K.Pr.C, apo shpalljen e arsyetuar të vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 308 të K.Pr.C si dhe duke respektuar gjithmonë afatin e caktimit të seancë gjyqësore në çështjet penale prej 15 ditëve të përcaktuara në nenin 342 pika 2, të K.Pr.Penale.

Referuar sa më sipër, për treguesit e *“numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”*, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 3.8 seanca gjyqësore, si dhe gjithashtu Gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, vlerësoj se Gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga Gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, Gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” Gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, duke e konsideruar numrin e seancave 1-3 dhe shkallë shumë të lartë të aftësisë për shmangien e seancave jo prductive.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ lidhur me këtë tregues, konkludohet sikurse është përshkruar në treguesin 2.B.A, me sipër “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 5 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve civile me palë kundërshtare, 5 kategorisë penale themeli dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore menjëherë ose deri në 12 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Për çështjet e përfunduara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin të gjitha seancat janë të regjistruara në sistem audio përveç një rasti, ku në procesverbalin e seancës është shënuar arsye e moszhvillimit, që ka të bëjë me mungesën e sallave të lira, ndërsa për 2 çështjet e përzgjedhura me short, të gjykuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë vitit 2014, nuk rezulton të jenë regjistruar në sistem audio, pasi është e njohur situata e kësaj gjykate sa i përket infrastrukturës dhe mungesës së numrit të nevojshëm të sallave për zhvillimin e të gjitha gjykimeve në sistem audio.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, Gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke urdhëruar njoftimet përkatëse për palët. Përgjithësisht drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), në kërkesën penale (*nenet 259 dhe 341 të K.Pr.Penale*) apo në çështjen penale të themelit (neni 335 e vijues dhe 405 i K.Pr.P). Ndërsa në dosjen penale që i përket vendimit nr.673-110-124, datë 10.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është konstatuar vendimi dhe procesverbali i shqyrtimit të kërkesës për vleftësim arresti, caktim mase sigurimi personal, si dhe gjykim të drejtpërdrejtë për dy të pandehur, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar në nenin 236/2 të K.Penale, kërkesë e cila është shqyrtuar në një seancë, për të cilën më pas është dhënë një vendim i përbashkët, në kundërshtim me parashikimet e nenit 245 të K.Pr.Penal në fuqi në kohën e shqyrtimit të kësaj kërkesë.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, Gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, legjitimitetin e mbrojtësit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të

ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, konstatohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarit në drejtim të planifikimit dhe menaxhimit të seancave gjyqësore të cilat përgjithësisht janë çelur në kohën e përcaktuar dhe vetëm në disa raste me vonesa, por duke relatuar gjithnjë shkaku e vonesës (*për shkak të qenies në gjykime të tjera*).

Në lidhje me këtë tregues gjyqtari paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal duke pretenduar se vetëm fakti i zhvillimit të disa seancave gjyqësore me vonesë për shkak të qenies në gjykime të tjera (delegime në gjykata të tjera si gjykata Krujë, duke evidentuar problematikën e delegimeve ku për periudhën 2013- 2016 ai është deleguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibë, Mat, Krujë dhe Lezhë, duke mund të cojë në një vlerësim mbi mesatar dhe pikëzim me 16 pikë.

Në raportin e vlerësimit është analizuar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të planifikimit dhe menaxhimit të seancave gjyqësore të cilat përgjithësisht janë çelur në kohën e përcaktuar dhe vetëm në disa raste me vonesa, vonesa të cilat nuk janë konsideruar problematike. Por ajo që është vlerësuar si problematike, që ka çuar në pikëzimin e gjyqtarit në nivel, mbi mesatar është zhvillimi i gjykimit për çështjen me objekt “Vleftësim arresti, caktim mase sigurimi personal dhe gjykim i drejtëpërdrejtë” për dy të pandehur të akuzuar për kryerjen e një vepre penale në bashkëpunin, në një gjykim, në kundërshtim me parashikimet e nenit 245 të K.Pr.Penal në fuqi në kohën e shqyrtimit e kësaj kërkesë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se Gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mbi mesatare në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 16 pikë.*

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtari, është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet proceduriale.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve procedurale dhe përgjithësisht rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbytur aktet e regjistrimit të çështjes dhe shortimit të saj, kërkesën/kërkesëpadinë dhe provat, vendimin për caktimin e seancës përgatitore dhe gjyqësore, njoftimet dhe shkresat e gjykatës sipas datave, procesverbalet e seancave, konkluzionet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet

paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se Gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet në të njëjtën mënyrë si në treguesin 2.C.A “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimet për vënien në lëvizje të çështjes, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, autorizime, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve, etj.). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se Gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit”.

AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
92	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3. 3.A. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Aurel Arapi ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës, në datën 15.05.2010 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2014. Pas studimeve, në datën 25.09.2015, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin ku vazhdon dhe aktualisht. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Aurel Arapi...”*

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Aurel Arapi, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 522, datë 01.04.2022, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”*.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
 - Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
 - Të dhënat për masa disiplinore;
 - Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit Aurel Arapi, në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Aurel Arapi është paraqitur gjithsej 1 (një) ankesë në Inspektoratin e ish - KLD. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut⁹⁰.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Aurel Arapi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Në përfundim, trupi gjykoës vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje*

⁹⁰ Miratuar në datë 10.03.2016, 02.03.2016 dhe 22.12.2015 nga Kryeinspektorata e Inspektoriatit të ish- KLD-së.

me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar, ku rezultoi që ai të ishte përfshirë. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se pas analizës financiare të përditësuar, pamundësia financiare minimale me burime të ligjshme, të shtrira përgjatë tri viteve nuk mund të përbëjë shkak për të konkluduar mbi për konstatimin e ndonjërit prej konstatimeve të nenit 33, pika 5, germat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 84/2016, ose ndonjë shkelje sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, apo për deklaram të mjaftueshëm, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.⁹¹

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.520, datë 30.03.2022, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të papabazura duke konkluduar se: *“Në këto kushte, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo prova mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, për sa kohë edhe deklarimi i tij mbi kontrollin e figurës ka rezultuar e saktë, konkludohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.”⁹²*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti*

⁹¹ Në faqen 15 të vendimit

⁹² Në faqen 23 të vendimit

dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Aurel Arapi. Për vetë gjyqtarin Aurel Arapi në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjor dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar akteve burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Për vetë gjyqtarin Aurel Arapi në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve....”*.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” vlerësohet se është “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Aurel Arapi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë dhe respektuar barazinë e palëve. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.”*

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e

palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Aurel Arapi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste që të ketë pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore gje kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, presumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, presumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Aurel Arapi i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e vlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 15 (pesëmbëdhjetë) seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, (shih të dhënat tek trajnimet e 3 vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 27 ditë të formimit vazhdues për një periudhë tre vjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit së shkallës së parë”.*

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.407/4 Prot., datë 10.07.2019, vërtetimit me nr. 403/1 prot., dt. 14.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari Aurel Arapi është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e

pjesëmarrëses në 15 aktivitete të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 27 ditë trajnimi.

Nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në trajnim jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti si dhe gjatë pesë viteve⁹³. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se *gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.*

Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në

⁹³ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se :” 1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrje.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit Aurel Arapi në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Sh.M, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë. Ndër të tjera rezultoi se ai ka marrë pjesë në 15 aktivitete të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, të zhvilluara për 27 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penal, gjithsej 15 aktivitete të zhvilluara për 27 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin Aurel Arapi ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional në periudhën e vlerësimit dhe si e tillë duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtari lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 nuk është angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë; fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin Aurel Arapi ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezultoi që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të kishte realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. Në këto kushte, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit u vlerësua se për gjyqtarin Aurel Arapi ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Pas njohjes me projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional gjyqtari paraqiti kundërshtimet e tij edhe për këtë tregues, duke pretenduar se për vlerësimin e tij nuk ishin vlerësuar botimet e tij si bashkëautor, me temë, “A cënohte parimi i procesit të rregullt ligjor sipas Nenit 6 të Konventës nga caktimi I mbrojtjesit nominalisht prej gjykatës”, botuar në Revistën jeta Juridike Nr.2, Qershor 2013, si dhe botimi me temë “Fitimi i munguar si dëm jashtëkontraktor dhe problematikat

gjqësore lidhur me të”, botuar në Revistën “Jeta Juridike” nr.4,viti 2015 të Shkollës së Magjistraturës, me ISSN, të cilat janë të aksesueshme në adresën zyrtare të internetit të Shkollës së Magjistraturës.

Në lidhje me këtë pretendim të gjyqtarit për marrjen e provave kryesisht nga relatori pranë çdo institucioni megjithëse nuk ishin të referuar prej tij tek formulari i vetvlerësimit dhe as ndodheshin në dosjen personale të gjyqtarit pranë Këshillit, çmohet të theksohet se Ligji “Për statusin” në nenin 92 të tij ka përcaktuar detyrën e relatorit të kërkoj dhe të mbledhë informacion vetëm nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me pjesmarrjen e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues, nga Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me përfundimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit si dhe nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit lidhur me saktësinë dhe korrektësinë e deklarimit të pasurisë dhe jo informacion që lidhet me treguesit e tjerë të vlerësimit si dhe nga çdo institucion tjetër.

Gjyqtari fillimisht nuk paraqit prova lidhur me këtë tregues, duke pretenduar kështu, se këto duhet të ishin marrë nga relatori dhe se tani mund të aksesoheshin nga ana e tij në faqen zyrtare të internetit të Shkollës së Magjistraturës. Pasi iu vu në dukje detyrimi i tij për të paraqitur provat që dëshmojnë angazhimin e tij për këtë tregues, Gjyqtari vuri në dispozicion të Këshillit, kopje të publikimit të tij në revistën nr.4 “Jeta Juridike ”, të botuar në Dhjetor të vitit 2015.

Në lidhje me artikullin e botuar në Revistën “Jeta Juridike” me nr.2, në qershor 2013, Këshilli vlerëson se ai nuk i përket periudhës së vlerësimit tetor 2013- tetor 2016. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe gjyqtari ka qenë gjatë vazhdimin të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht në vitin e dytë të shkollës (tetor 2012- Korrik 2013), sipas ligjit Nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërsa artikulli, me temë “*Fitimi i munguar si dëm jashtëkontraktor dhe problematikat gjyqësore lidhur me të*”, botuar në Revistën “Jeta Juridike” nr.4, viti 2015 të Shkollës së Magjistraturës, me bashkëautor Aurel Arapi dhe Sokol Pina i përket periudhës së vlerësimit, e për pasojë do të merret në konsideratë.

Kështu, duke marrë parasysh kundërshtimet dhe provat e paraqitura nga gjyqtari, me anë të cilës u provua se publikimi ligjor akademik me bashkëautorsi është botuar në muajin dhjetor 2015, e cila brenda periudhës së vlerësimit nga ana e relatores u propozua ndryshimi i pikëzimit për këtë tregues nga 0 në 5 pikë, të cilat u miratuan nga Këshilli.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

NIVELI E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	77	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	92	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	96	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	365	Shumë mirë

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN AUREL ARAPI PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 - 2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE			Piket total	Niveli i vlerësimit	
			77	Shumë mirë	
Treguesit	Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologji	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi mesataren	12	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mesatare	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				92	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Më e shkurtër ose e barabartë	5	Koha mesatare:

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve.		<p>Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë</p> <p>Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë</p> <p>Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Mbi 87- 93 %	6	<p>Tej standardit :</p> <p>Nën 81 %- 2 pikë</p> <p>Mbi 81-87 % - 4 pikë</p> <p>Mbi 87- 93 % - 6 pikë</p> <p>Mbi 93-99 % - 8 pikë</p> <p>+99% - 10 pikë</p>

	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së	Mbi mesataren	16	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë

		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuase	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuase: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				96	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë

		vlerësimi (6 dosjet e përzgjedhura me short);			
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit;	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	• Dosja e rivlerësimit;	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë

					Ka të dhëna – 1 deri në 5 pi
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shumë mirë		
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			365		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR